



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E INTEGRIMIT
EUROPIAN**

“Dyer të hapura për rininë”, dita e Europës në festohet në Tiranë

2017-05-09 15:01:00



Ministria e Integrimit European, në bashkëpunim me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, zhvilloi sot në Tiranë aktivitetin “Dyer të hapura për rininë” në kuadër të ditës së Europës.

Ministrja Gjoshë: Qytetarët kanë nevojë ta ndërtojnë në Shqipëri jetën europiane të fëmijëve të tyre

Ministria e Integrimit European, në bashkëpunim me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, zhvilloi sot në Tiranë aktivitetin “Dyer të hapura për rininë” në kuadër të ditës së Europës.

Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin Kryetari i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Presidenti i ardhshëm z. Ilir Meta, Ministrja e Integrimit European, znj. Klajda Gjoshë, Ambasadorja e Bashkimit European në Shqipëri, znj. Romana Vlahutin, trupa diplomatike e vendeve anëtare të BE, përfaqësues të shoqërisë civile dhe dhjetëra të rinj.

“Qytetarët tanë kanë nevojë që ta ndërtojnë jetën europiane të fëmijëve të tyre këtu, në vendin e tyre. Dua të theksoj se pavarësisht se gjatë gjithë këtyre viteve vazhdimisht procesi i integrimit mund të jetë dukur si një proces teknik, proces i reformave të mëdha, qëllimi i tij është vetëm një: Jetë më e mirë për qytetarët tanë”, tha Ministrja Gjoshë në fjalën e saj.

Ministrja theksoi se pavarësisht ngjyrës politike të gjithëve u vjen mirë për sukseset që ka patur Shqipëria me procesin e integrimit katër vitet e fundit duke përmendur statusin e vendit kandidat në 2014 dhe marrjen e rekomandimit pozitiv në 2016.

“Këto arritje ato i përkasin shqiptarëve ashtu siç i përket atyre procesi i integrimit. Ndaj nuk ndjehem mirë, për të qenë e sinqertë, që në vend që këto hapa t’i kurorëzojmë me një tjetër fitore, atë të çeljes së negociatave, vendi sot gjendet në një ngërç të pajustificuar politik, i cili trondit themelet e demokracisë, por edhe vizionin për të ardhmen e vendit tonë”, tha Ministrja Gjoshë.

Ministrja Gjoshë, ftoi të rinjtë të kontribuojnë në procesin me energjinë dhe vizionin e tyre për procesin e integrimit, duke i hapur kështu rrugën të ardhmes europiane të vendit.